

**VENDIM**  
**Nr.16, datë 6.3.2009**

**PËR PROPOZIMIN E DISA SHITESAVE NË “MODELIN E TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 9 dhe të nenit 53, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve, në mbledhjen e tij të datës 6.3.2009, pasi shqyrtoi propozimin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, si dhe të Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për disa ndryshime në modelin e tregut të energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008 dhe konstatoi nevojën e përcaktimit në modelin e tregut të energjisë elektrike të një minimumi të lejueshëm të disbalancave, devijimeve, për të cilat pjesëmarrësit e tregut nuk paguajnë sanksione,

**VENDOSI:**

1. Miraton propozimin për disa shtesa në “Modelin e tregut të energjië elektrike”, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr.338, datë 19.3.2008, të cilat do t’i propozohen për miratim Këshillit të Ministrave, me përmbajtjen si më poshtë:

A. Në pikën 5.4, në fund të fjalisë shtohet paragrafi:

Disbalancat (devijimet) nga programi javor në masën +/- 5%, do të konsiderohen si disbalanca (devijime) për të cilat pjesëmarrësit e tregut nuk do të paguajnë sanksione, por ato janë të detyruara që për javën/javët pasardhëse të planifikojnë rregullimin e këtyre disbalancave (devijimeve).

B. Në pikën 6.1, paragrafi i fundit – të arkëtueshme/të pagueshme, të vedoset +/- 5%.

C. Në pikën 6.2, paragrafi i fundit – të arkëtueshme/të pagueshme, të vedoset +/- 5%.

D. Në pikën 6.4, paragrafi i fundit – të arkëtueshme/të pagueshme, të vedoset +/- 5%.

E. Në pikën 6.5, paragrafi i fundit – të arkëtueshme/të pagueshme, të vedoset +/- 5%.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI I ERE-S**  
**Bujar Nepravishta**